



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350-30592/15
Kaçanik, 29.09.2015

Në bazë të nenit 40.2(i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës: 04 qershor 2008), të Udhëzimit Administrativ 12/2012 -Për përcaktimin e emërimit dhe numërimit të adresave për zonat e qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të Lira, i MMPH i datës 03.07.2012, të nenit 6.2(p) të Statutit të Komunës, si dhe nenit 15.1(i) dhe 15.6 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29.09.2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR RISHIKIMIN E PROCESIT TË EMËRTIMIT
DHE RIEMËRTIMIT TË RRUGËVE LOKALE

1. Me këtë Vendim, formohet komisioni për rishikimin e procesit të emërtimeve dhe riemërtimeve të rrugëve lokale, në teritorin e komunës së Kaçanikut, në përbërje:

1.1. Fatos Koxha,	nga ekzekutivi i komunës, caktuar nga Kryetari i Komunës,
1.2. Burim Çaka,	nga ekzekutivi i komunës, caktuar nga Kryetari i Komunës,
1.3. Kemal Mërseli,	anëtar i kuvendit të komunës
1.4. Kadri Krivenjeva,	anëtar i kuvendit të komunës, dhe
1.5. Nazife Krasniqi,	anëtare e kuvendit të komunës.
2. Kryetari i komisionit zgjidhet nga radhet e anëtarëve të komisionit.
3. Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi ka për detyrë të rishikoj procesin e emërtimeve dhe riemërtimeve të rrugëve lokale në territorin e komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve të komunës dhe rezultatet e arritura t'ia prezentoj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të MAPL.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe organet tjera relevante nga ekzekutivi i komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi